

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Sahit Krasniqi-kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve profesional Musa Konxheli dhe Akile Ilazi-anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit: F.A., për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.44/15 të dt.22.05.2015, pas shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura me 03.11.2015, 22.01.2016, 15.03.2016, 12.04.2016, 19.05.2016 në prani të Prokurorit të shtetit Florije Salihu- Shamolli, të akuzuarit F.A. dhe mbrojtësit të autorizuar të tij av.Sh.Sh., të dëmtuarit E.M. dhe përfaqësuesi i tij me autorizim av.Z.Z., më 20.05.2016 shpall dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **F.A.**, Gjilani, data e lindjes....në fsh.....K.Gjilan, me vendbanim në rrugën “.....” nr.... Gjilan me nr.personal, nga i ati A., dhe e ëma H. e vajzëris Sh., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, menagjer i Kompanisë së sigurimit “, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse Në muajin nëntor të vitit 2013, në Ferizaj, në pompën e derivateve, në mënyrë të drejtpërdrejt ka marr të holla 7000 Euro nga H.M. e të cilat para i ka kërkuar nga F.M.-bashkëshortja e të dëmtuarit E.M., në mënyrë që të ushtroj ndikim të drejtpërdrejt tek personi zyrtar Gjyqëtar, e Prokuror, në atë mënyrë që i pandehuri pas kontaktit me bashkëshorten e viktimës i ka premtuar se me ndërmjetsimin e tij do të lirojn E.M. nga qendra e paraburgimit dhe se duhet ti siguronin 7000 Euro, sa më shpejt që është e mundur, pasi që e dëmtuara jeton në Zvicërr edhe në pamundësi që të takohet me te pandehurin, thret një mik të burrit të saj H.M. dhe ky i fundit ja jep në dorë të hollat në shumën e sipërcekur tek pompa e derivateve

-me këtë kreu veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par 1 të KPK-së.

Andaj gjykata në baze të dispozitave të përmendura dhe në bazë të nenit 3,5,6,11,15,34,36,38,64, dhe 73 të KPK-së, si dhe neni 365 të KPPK-së të **akuzuarin**, F.A. e,

G J Y K O N

Me DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim i akuzuari do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Obligohet i akuzuari F.A. që të dëmtuarit E.M. të ja kthej dëmin e shkaktuar në shumë prej 7000 euro.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro, në afat prej 15 (pesmdhjet) ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për krime të rënda me aktakuzën PP.nr.I-44/15 të datës 22.05.2015, e ka akuzuar të akuzuarin F.A. për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK- së.

Gjykata duke vepruar në këtë qështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me datën:03.11.2015,ku Kryetari i trupit gjykues,komform neni 246 të KPPRK-së i ofron mundësin të pandehurit të pranoj fajsin ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri F.A. nuk e pranon fajsin për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza,kurse avokati i të akuzuarit me datën 30.11.2015 paraqiti kërkesën për hudhje të akuzës.

Lidhur me kërkesën për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës kryetari i trupit gjykues mbajti shqyrtimin e dytë gjyqësor me dt. 22.01.2016, ku në të njëjtin shqyrtim gjyqësor duke u bazuar në propozimin e prokurorit të shtetit morri aktvendim dhe refuzoi kërkesën mbrojtësit të të akuzuarit për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata gjithashtu caktoi dhe mbajti shqyrtimet gjyqësore me dt. 15.03.2016, 12.04.2016, 19.05.2016 dhe 20.05.2016, ku në shqyrtimin e dt. 19.05.2016 prokurori i shtetit Florije Salihu-Shamolli bëri ndryshimine dispozitivit të aktakuzës: ashtu që në përfundim të rreshtit të dyt duhet të jet pas fjalës” nga shtohet fjala F.M.”ndërsa te rreshti i katërt pas fjalës “personi zyrtar” shtohen fjalët” Gjyqtar dhe prokuror” dhe në fjalën përfundimtare deklarohet që mbetet pran aktakuzës së ndryshuar tani në shqyrtimin gjyqësor dhe pran kualifikim it juridik për veprën penale ushtrim i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së,

i propozoi trupit gjykues që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i parapar me ligj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit E.M. av. Z.Z. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua shumë bindshëm se i akuzuari F.A. ka kryer veprën me të cilën e ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit duke e dëmtuar E.M. në vlerën monetare prej 7000 euro kjo shumë e parave nuk u kontestua as nga i akuzuari dhe u vërtetua nga dëshmitaret e dëgjuar gjatë kësaj qështje penale, ndërsa sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit se këto mjete janë marrë për një destinacion tjetër dhe jo për gjyqtaret dhe prokurorët apo dikënd tjetër i akuzuari me asnjë provë nuk e vërtetoi se vërtet këto mjete i janë dhënë siq u deklarua disa personave të panjohur kinse sipas marrveshjes me të dëmtuarin E.M.. Deklarimi i tij se këtë shumë të parasë e ka marrur për të i kryer disa obligime të të dëmtuarit i akuzuari nuk arriti ta vërtetojë aq më shumë kurë siq u deklarua gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor se i dëmtuari E.M. ka prirje për skenarë dhe duke e pasur i akuzuari këtë dyshim ndaj një shume relativisht të madhe shumen 7000 euro sikur të i ja kishte dhënë dikujt tjetër jo për atë që i ka kërkuar do të kishte poseduar një provë së paku për ta bindur tani të dëmtuarin se vërtet këto para i ka dhënë në personat në të cilët aludon i akuzuari. Andaj mendoj se kjo deklarat dhe ky arsyetim nuk u vërtetua me asgjë dhe me asnjë provë nga i akuzuari por u vërtetua shumë qartë dhe shumë bindshëm nga aktakuza e prokurorit të shtetit se i akuzuari ka kryer veprën penale sipas dispozitivit të kësaj aktakuze andaj duke pasur parasyshë se janë si në trend dhe është bërë si praktik nga shumë qytetar të Kosovës që të thirren në emër të personave zyrtar, i propozoj gjykatës që të akuzuarin F.A. ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, sepse konsideroj se një dënim meritor është në interes të preventives speciale dhe asaj gjeneralë. Gjithashtu gjykatës i propozoj që në të njëjtin aktgjykim të akuzuarin ta detyroj që të dëmtuarit të i ja kthejë shumën prej 7000 euro, meqë kjo shumë nuk është kontestuar nga asnjëra palë në procedur.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në shqyrtimin fillestar si dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale ushtrim i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së,përkatësisht nuk e ka kontestuar faktin se ka pranuar shumën e të hollave prej 7000 euro, si dhe faktin se E.M. e ka takuar me ftesë të avokates së tij apo të bashkëshortes së tij nuk i kujtohet , ku njëri prej tyre e ka ftuar përmes telefonit që të takohen me E.M. para gjykatës. Dhe nuk i kujtohet se a e ka ftuar avokati A.I. apo avokatja S.M.. Gjithashtu e di se 500 euro të cilat i ja kam pasur borxh E.M. në emër të mbrojtjes së tij i ja kam dhënë njërit prej avokatëve por nuk e di se a i ja kam dhënë avokatit A.I. apo avokates S.M.. Pasi që unë jam takuar me të dy avokatet si me A.I. njashtu edhe me S.M. të hollat nuk më kujtohen cilit i ja kam dhënë. Është e vërtet se pasi E.M. ka dalur nga paraburgimi jemi takuar në qendrën tregatëre “.....” në Gjilan ku me E.M. kishte qenë edhe një djal i vëllait të tij dhe në prezencën e nipit të tij i kam thënë E.M. “a u lirove nga paraburgimi” ku në prezencën e tij e kemi përmendur personin X, dhe i kemi thënë ati djalit që të largohet nga vendi ku ishim ulur ku unë pastaj me E.M. kemi filluar bisedën dhe kemi folur shumë gjatë lidhur me skenat që i kemi bërë me të shoqen dhe me të tjerët kur kanë qenë prezent. Të hollat prej 7000 euro nuk po më kujtohet se a i ka përmendur në këtë vend takim. E.M. mua më ka ftuar me telefonin e tij privat mobil të tij. Në pyetjen tjetër lidhur me shënimet e personave të cilëve i ju ke dorëzuar shumene të hollave prej 7000 euro ose ndonjë numër të telefonit të tyre i akuzuari deklaroi se unë nuk kam asnjë shënim mbi identitetin e tyre, adresene tyre e as numrat e telefonave të tyre, ashtu që unë nuk kam kurrfarë njohurie për adresat e tyre dhe identitetin e tyre, se unë të hollat që i kam marrë personi i cila ka dëshmuar këtu në gjykat të njëjtat a kam dërguar personave që më ka thënë E.M..

Mbrojtësi i autorizuar i të akuzuarit F.A. av. Sh.Sh. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Në njëfar mënyre,gjat këtij shqyrtimi ,isha duke pritur që përfqasuesja e akuzës,si dhe pas dëgjimit të dëshmitares F.M. e cila është bashkëshortja e të dëmtuarit E.M.,si dhe vetë të akuzuarin F.A. do ta shqyrtonte mundësin e heqjes dorë nga ndjekja e mëtejme penale ose të bëj rikualifikimin e veprës penale.gjate këtij procesi në të cilën jan administruar të gjitha provat ,mbrojtja është e bindur që përfaqësuesi i aktakuzës nuk ka arritur ta vërtetoj se i mbrojturi im është kryes i veprës penale,me të cilën është akuzuar,andaj nga trupi gjykues e presum një vendim të ligjshëm dhe të drejt,dhe besojm që do të jet në favor të të mbrojturit tim .

Prokuroria e shtetit pretendon qe i mbrojturi im F.A. ne menyre qe te ushtroj ndikim te padrejte ne vendimmarrje tek personi zyrtar pas nje kontakti te realizuar me bashkëshorten e te dëmtuarit, E.M. i ka premtuar se me ndermjetsimin e tij do ta liroj te dëmtuarin nga qendra e paraburgimit mirëpo duhet urgjentisht te gjinden 7000euro. Tutje sipas prokurorisë, bashkëshortja e te dëmtuarit, duke qene se jeton ne Zvicerr, dhe ne pamundësi per ta takuar te mbrojturin tim, ka arritur qe nerpermjete H.M., i cili eshte mik/ shok i burrit te saj , te hollat ne shume prej 7000 euro ia ka dhene te mbarturit tim.

I nderuari trup gjykues, prokurira nuk ka arritur te vërtetoj, as edhe me te vetmen provum egzistimin e veprës penale te ushtrimit te ndikimit.

Sidoqoft me nje vlerësim te kujdesshëm te te gjitha provave, arrijmë ne përfundim qe i mbrojturi im me veprimet e tij nuk ka konsumuar elementet e veprës penale te ushtrimit te ndikimit.

Duke qene se i dëmtuari është marre me kontabandim me migrante dhe ne pamundesu personalisht t'ua kthej te hollat personave te kontrabanduar sepse i dëmtuari ne ate kohe ishte ne burg, i mbrojturi im ne bashkëpunim me E.M. e kane sajuar punën e intervenimit per lirimin e E.M. nga burgu. Qëllimi i kësaj është bërë qe mos ta ngarkojnë bashkëshorten e E.M., ndërsa te hollat e pranuar ne emër te kinse ndikimit per ta liruar E.M., u janë kthyer personave te cilëve E.M. iu kishte marrur te holla per t'i kontrabanduar ne vendet treta.

Këtë e konfirmon dëshmitarja F.M.,e cila,para këtij trupit gjykues ka deklaruar që F.A. nuk ka ndikuar për lirim të E.M. por vetëm e ka mashtruar atë.

Sajimin e ngjarjes se kinse ushtrimit të ndikimit e ka shpjeguar dhe i mbrojturi im në deklaratën e tij,e cila ka qen e singert dhe kredibile.

Dua të sjelli në vëmendjen tuaj dhe qështjen e leximit të sms-ve të siguruar nga pala e dëmtuar. Mbrojtja dhe mëtej konsideron që aktgjykimi nuk mund të bazohet në përmbajtjen e sms-ve,sepse sigurimi i tyre është bërë në kundërshtim me dispozitat e kodit të procedurës penale. Me fjalë të tjera, nuk janë kërkuar nga prokuroria dhe nuk janë urdhëruar nga gjykata nëpërmjet masave të fshehta të përgjimit të telekomunikimeve,dhe rrjedhimisht janë prova të papranueshme.

Andaj,duke i pasur parasyrsh këto që u than më lart, me të drejt kërkojm që, në mungesë të provave,i mbrojturi im të lirohet nga akuza.

I akuzuari F.A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij av.Sh.Sh..

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajsin për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së, gjykata ka bërë paraqitjen provave dhe pas vlersimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dipozitës së nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit;
- nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit E.M.
- nga dëshmia e dëshmitares F.M.
- nga dëshmia e dëshmitarit H.M.

- nga modulari i tërheqjes së të hollave të datës 12.05.2014, ku shifet se në këtë datë H.M. nga i ka tërhequr 1240 euro, i dt.02.2014 ku shifet se H.M. i ka tërhequr shumën prej 394.40 euro, . 27.12.2013 ku shifet se dëshmitari H.M. i ka tërhequr nga shumën prej 4,192.22 euro
- nga shiqimi në fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës përkatsisht në SMS-ët e dorëzuar nga pala e dëmtuar E.M., bashkëshortes së të dëmtuarit F.M., të cilat i ka zhvilluar me të akuzuarin F.A., dhe atë përmes rrjetit të Viber ku kanë shkëmbyer disa SMS-ë të cilat i ka sjellë i dëmtuari.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Dëshmitari- i dëmtuari E.M. deklaron:

me dt.15 nëntor 2013 nga Policia e Kosovës ishte arrestuar për një veprë penale kontrabandimi me migrant dhe si avokat e kishte angazhuar av. S.M., i akuzuari F.A. ia kishte pasur borgj 500 euro të cilat ia kishte marrë uha para 4-5 muajve para se me ndodh

arrestimi im, ai avokates S.M. i ja kishte dhenë numrin e telefonit të të akuzuarit F.A. me qëllim që ajo nga ai të i kërkoj 500 euro në emër të përfaqsimin përkatësisht mbrojtjes që më kishte ofruar me rastin e caktimit të paraburgimit. F.A. të hollat e kërkuara në shumë prej 500 euro i ja kishte dhenë avokates S.M. me datën 16.11.2013 dhe të njejtën ditë i akuzuari F.A. kishte shkuar tek shtëpia në fshatin dhe aty prindërve të mi i ju kishte treguar se mua më është caktuar paraburgimi dhe ju kishte thënë që të mos merakosen për shkak se unë brenda dy jave do ta nxjerrri nga paraburgimi të cilëve u kishte lënë numrin e telefonit të tij dhe pastaj prindërit e mi numrin e telefonit të të akuzuarit i ja kanë dhenë bashkëshortes F.M. e cila ka qenë duke punuar përkohësisht në Zvicër.F.M. e kishte thirrë F.A. dhe kanë biseduar me të lidhur me daljen time nga paraburgimi, ku në atë rastë përmes telefonit F.A. i kishte thënë asaj që të mos merakoset se E.M. brenda dy jave do të i ndërpritet paraburgimi vetëm se duhet me i gjet 7000 mijë euro të cilat duhet me i ja dhenë një personi X pa e përmendur emrin e tij dhe se këtë shumë të të hollave duhet me e gjet deri të nesërmen në ora 08 të mëngjesit. Bashkëshortaja ime për të i gjetur këto të holla e ka thirrë shokun tim H.M. i fsh. të cilit i kishte thënë se duhet me i gjet urgjentisht 7000 mijë euro dhe të njëjtat me i ja dhenë të akuzuarit F.A., i cili këtë shumë të hollave ditën e nesërme i kishte gjetur dhe i ja kishte dorëzuar të akuzuarit në ora 09:00. Bashkëshortja ja kishte dhenë numrin e telefonit të akuzuarit F.A. dhe në numrin e tij të telefonit H.M. e ka thirrë të akuzuarin dhe pasi që ishin takuar tei, H.M. i ja kishte dhenë të akuzuarit 7000 mijë euro. H.M. mua më ka treguar kur ka ardhur në vizitë në Qendren e paraburgimit në Lipjan se shumë e të hollave prej 7000 mijë euro qi i ja kishte dhenë të akuzuarit kishin qenë për ndërprerjen e paraburgimit. Pas një jave që më ka njoftuar H.M. për këto të holla unë e kam thirrur bashkëshorten time në telefon dhe e kam pyetur për qështjen e këtyre të hollave e cila më tregoi se këto të holla i ja ka dhenë të akuzuarit përmes H.M. sepse ai ka premtuar se brenda dy jave do të më nxjerr mua nga paraburgimi. F.A. përmes telefonit më ka thënë se ti ose do të dënohesh me kusht ose do të lirohesh krejtësisht nga akuza dhe më ka thënë që mos ta zgjas shumë këtë bisedë përmes telefonit sepse mund të priset puna. Pas ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit me datën 23.07.2014 mua më është ndërprer paraburgimi pasi në emër të dorëzimit kam paguar shumë prej 10 mijë euro, dhe pas deponimit të kësaj shume në vend të masës së paraburgimit më është caktuar masa e paraqitjes në Stacionin Policor. me dt. 24.07.2014.,. Menjëherë pas ndërprerjes së paraburgimit unë kam bërë përpjekje që të takohem me të akuzuarin, pas një kohe jemi takuar dhe me ka thënë se këto të holla i ja kam dhenë një personit X i cili është i fortë, i cili ka ndiku në Gjykatë por nuk më ka treguar emrin e këtij personi. Unë pasi jam bindur se përmes këtyre të hollave nuk është kryer puna e lirimit tim

nga paraburgimi nga i akuzuari kam kërkuar që të më i kthen shumën prej 7000 mijë euro i cili më tha se këtë shumë të të hollave duhet të ti kthej por duhet të pres për 2 muaj. të cilit unë i kam dhënë afat tre muaj, por as pas tre muajve i njëjti nuk mi ka kthyer këto të holla dhe më tha se nuk ti jap se punën e kam kryer për atë ti je në liri.

Nga Deshmia e dëshmitares F.M. vërtetohet se ajo në kohën e arrestimit të bashkëshortit, në muajin nëntor të vitit 2013 ka qenë shtetin e Zvicrës dhe të njëjtën ditë apo të nesërmen kur E.M. ka pasur me ardhë në Zvicër i njëjti ishte arrestuar nga policia për shkak të një veprë penale kontrabandimi me migrant. Të njëjtën ditë për arrestimin e tij më kanë njoftuar familja e E.M., ku ata më thanë se kishin ardhë policia dhe e kishin marrë E.M., në mbramje kur kam thirrë në familjen e E.M. familjarët e tij më treguan se te shtëpia jonë ka ardhur një shokë i gjagjit (E.M.) i quajtur F.A. i cili kishte qenë në seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore në Ferizaj kur E.M. i ju kishte caktuar masë e paraburgimit dhe më thanë që të mos bëhemi merak se do të bëhet mir'. Familjarët e E.M. nga personi i quajtur F.A. e kishin marrë edhe numrin e telefonit të tij të cilin numër e morra unë por tani nuk po më kujtohet përsërisht dhe përmes këtij numri unë e kam thirrë F.A. disa herë me të cilin kemi biseduar për qështjen e paraburgimit të bashkëshortit tim E.M.. Ai gjatë bisedës më ka thënë edhe mua që të mos bëhem merak se natën e vitit të ri E.M. do ta kesh te shtëpia por për të u kryer kjo punë më ka thënë që duhet të i sigurosh 7 mijë euro dhe atë brenda një ore e më së largu gjerë të nesërmen në mëngjes gjerë në ora 9. Këto fjalë F.A. mi ka thënë dy - tri javë pasi që ju kishte caktuar E.M. paraburgimi. Me qenë se unë nuk i kisha 7 mijë euro e kam ftuar shokun e bashkëshortit tim H.M. dhe i kam thënë që nëse ke mundësi që të mi gjen 7 mijë i kam thënë se më nevojiten për të kryer një punë, ku në fillim më tha se nuk i kam të gjitha këto 7 mijë euro por do të mundohem që të i gjej. të njëjtën natë rreth orës 24:00 përmes euro i cili më pyeti se për çfarë arsye po të duhen por unë nuk i kam treguar arsyen vetëm telefonit H.M. më ka njoftuar se i ka gjetur 7000 mijë euro që unë i kisha kërkuar nga ai, dhe H.M. i ja kam dhënë numrin e telefonit të F.A., po ashtu edhe F.A. i ja kam dhënë numrin e telefonit të H.M. që ata të kontaktojnë në mesë vete dhe të takohen dikund për të i ja dhënë H.M. të hollat F.A., pasi që F.A. i kishte kërkuar për të nesërmen në ora 09:00. Të nesërmen në mëngjes rreth orës 08:30 H.M. me F.A. ishin takuar dikund por vendi se ku janë takuar mua nuk po më kujtohet por që të dytë më kanë njoftuar përmes SMS-ve se H.M. i ja ka dhënë F.A. të hollat në shumë prej 7000 mijë euro. Unë kam pritur se bashkëshorti im E.M. do të lirohet nga paraburgimi siq më ka premtuar F.A. për natën e vitit të ri, por me qenë se kjo nuk ndodhi, bile një herë ditën e krishlindjeve para vitit të ri i ja kam përkujtuar F.A. se

gati viti i ri erdhi por ai më tha se ende është larg viti i ri. Ashtu që unë kam mbetur në pritje duke shpresuar se për vitin e ri do të lirohet bashkëshorti im nga paraburgimi. Pasi që bashkëshorti im nuk u lirua unë kam biseduar me F.A. në telefon pas kalimit të vitit të ri por i njëjti vazhdimisht më ka thënë se ende nuk janë kryer hetimet, se duhet dëgjohet edhe një dëshmitar, dhe qdo herë e gjejke ndonjë arsye, gjersa në muajin prill të vitit 2014 kur kam ardhur nga Zvicra në shtëpi në fsh., , jam takuar me F.A. te restoranti natyral në Sojevë, aty kemi porositur nga një kafe dhe gjatë bisedës me të të njëjtin e kam pyetur se qysh i kemi pasur fjalët, se ti më ke premtuar se E.M. do të lirohet me Vitin e ri kurse tani po e shefe se jemi në muajin prill, mirëpo ai më ka thënë se unë e kam një person të fort një dajë i cili e njeh dikan, emrin nuk e tregojke por është personi X i cili është menjëherë mas Thaqit dhe ai do të bisedoj me gjyqëtar dhe prokuror për ta liruar E.M. nga paraburgimi. F.A. gjersa kimi pi kafe në restorantin Natyral siq e kam pa situatën edhe ti je e rrezikune me u arrestu, por arsyen pse mi ka thënë këto fjal nuk e di a ka dasht ende pare tjera apo diqka tjeter, por më ka thënë rri pa merak se i kemi këta të fortit dhe nuk guxojn me të prek. Gjatë qëndrimit tim në pushim në kohëzgjatje prej dy jave në Kosovë me datë nuk më kujtohet por unë jam takuar me F.A. edhe dy-tri herë te Restorant në dhe në qdo takim unë e kam pyetur se a ka diqka të re lidhur me lirimimin e E.M. nga paraburgimi. Unë gjatë bisedës që e kam zhvilluar me të si përmes telefonit njashtu edhe kur jam takuar disi më ka bindur se ky mundet me kry punë, se në bazë të qëndrimit të tij dhe në bazë të fjalëve të tij pasi që edhe veturën e kishte mjaft luksoze, gjithashtu edhe mosha e tij më kanë bindë se ky është një person i cili po mujka me kry punë duke përfitur përshtypjen se ky njeh shumë persona dhe mund të ketë ndikim në lirimimin e bashkëshortit tim nga paraburgimi. Unë në fillim siq theksova më lartë nuk i kam treguar H.M.t se për qka po më nevoiten këto të holla, kurse me E.M. në fillim nuk kam mundur të komunikoj përmes telefonit e pas një muaji e gjysmë apo dy i kam treguar H.M. se për qka i ja kam kërkuar shumen e të hollave prej 7000 mij euro. H.M. i kishte treguar E.M. që të rrin pa merak se e kem gjet një lidhje për lirimimin e tij sa më të shpejt nga paraburgimi. Gjatë bisedës telefonike që e ka zhvilluar me mua E.M. më ka thënë se ti i paske dhenë këto të holla por edhe 50 mij me i dhanë se kjo punë me pare nuk kryehet por vetëm në mënyrë të ligjëshme, kurse unë E.M. i thojsha se kjo punë sigurisht do të kryhet duke shpresuar ende në F.A. i cili i kishte marrë të hollat për këtë qëllim. Pas disa premtimeve që mi thojke F.A. kohë pas kohe gjersa E.M. ishte në paraburgim në fund u binda se F.A. nuk ka pasur kurrnjëfar lidhje me askënd për ta liruar bashkëshortin tim nga paraburgimi, sepse E.M. në fund u shpallë fajtor u dënua me burg prej një viti dhe me gjobë në shumjé prej 500 euro dhe se paraburgimi i është ndërprer pasi që si kaucion ka dhenë shumen prej 10 mij euro, dhe

prap ai nuk është liruar krejt nga paraburgimi por kjo masë i është zëvendësuar me masen e paraqitjes në Stacionin Policor. Pasi E.M. është liruar nga paraburgimi kthimin e të hollave në shumë prej 7000 mijë euro e ka kërkuar vetë E.M., se unë më tutje me F.A. nuk kam kontaktuar edhe numrin tim të telefonit e kam ndërruar për të mos më thirre.

Deshmitari H.M. deklaron:

Kah fundi i vitit 2013 permes telefonit e ka ftuar bashkëshortja e E.M. F.M. e cila e ka pyetur se a mundesh me i siguruar 7000 mijë euro por nuk ka treguar arsyen se perse i nevoiten këto te holla, por vetëm ka thene se është puna ashtu që urgjentisht i nevojitet kjo shumë e të hollave. Une në fillim i kam thënë se nuk i kam 7000 mijë euro por po shqioj mundësin e sigurimit të tyre nga vëllezërit e mi. Të njëjtën ditë në mbrëmje kam kontaktuar me vëllezërit e mi dhe këtë shumë të të hollave i kam siguruar duke i huazuar nga vëllezërit e mi dhe në të njëjtën mbrëmje në orët e vona e kam ftuar F.M. se të hollat e kërkuara i kam siguruar - i kam gjetur. Fikretja më ka thënë se këto të holla duhet me i ja dhanë personit të quajtur F.A. e cila edhe më ka dhënë numrin e telefonit të tij dhe më ka thënë se ai të thërret në numrin e telefonit tuaj dhe pasi ta caktoni terminin këto të holla më ka thënë që unë të i ja dorëzoj ati. Të nesërmen në mën gjësë F.A. më ka ftuar përmes telefonit në telefonin tim dhe pasi është prezantuar se është F.A. më ka thënë që të takohemi tei në udhëkryqin e magjistrales, dhe pasi që unë paraprakisht isha i njoftuar nga ana e F.M. kam shkuar teki mirëpo pasi që F.A. nuk e njofsha të njëjtin e kam thirre përmes telefonit i cili kishte qenë ulur brenda në restorantin e dhe e ngriti dorën lartë, atëherë unë jam afruar dhe pasi F.A. e porositi nga një kafe unë ashtu siq jemi marrë veshë desha që të i ja dorëzoj të hollat aty sa kemi qenë ulur por ai nuk pranoi të i merre të hollat aty por shumën prej 7000 mijë euro i ka marrë nga unë në automjetin e tij të tipit Audi me ngjyrë të zezë i cili kishte qenë i parkuar në parkingin e Unë nuk e kam pyetur fare se përse po i duhen këto të holla. Menjëherë pas dorëzimit të të hollave ky ka vazhduar rrugën për në drejtim të Prishtinës kurse unë menjëherë e kam lajmëruar F.M. se të hollat në shumë prej 7000 mijë euro i ja kam dorëzuar F.A.. Shumën e të hollave prej 7000 mijë euro mua mi ka kompenzuar i dëmtuari E.M. përmes djalit të vllait t tij A.M. i cili këto të holla mi ka dërguar prej Zvicres përmes dhe të në tri rata dhe të me dt. 12.05.2014 mi ka dorëzuar 1240 euro, me dt. 11.02.2014 mi ka dorëzuar 394.40 euro kurse me dt. 27.12.2013 mi ka dorëzuar 4,192.22 euro , ndërsa 1200 euro mi ka dorëzuar pas një muaji të holla të gatshme në dorë personalisht E.M. pasi e ka përfunduar paraburgimin. Përsonit të cilit i ja kam dhënë të hollat në shumë prej 7000 euro gjindet këtu në sallën e gjykimit, në bankën e të akuzuarve (këtë e vërteton duke e drejtuar gishtin në

drejtim të tij). Unë E.M. e kam shokë që nga shkolla e mesme me të cilin jemi shoqëruar edhe pas përfundimit të shkollës.

Dëshminë e të dëmtuarit E.M. dhe dëshmit; e dëshmitarve F.M. dhe H.M. trupi gjykues i vlerësoj si dëshmi të besueshme dhe të vërteta,

Me që janë indentike me dëshmit e tyre të dhëna në procedurën hetimore dhe të konfirmuara në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e të pandehurve, janë të detajizuara, konkretizuara dhe logjike, njëkohësisht të njëjtat janë në harmoni reciproke si në mes vehte njëashtu edhe me provat tjera materjale, si me leximin e disa SMS-ve, modulari i tërheqjes 12.05.2014, 11.02.2014, 27.12.2013, andaj trupi gjykues nuk gjeti ndonjë arsye që do të vënte në pyetje besueshmërin e këtyre dëshmime.

Nga shikimi në listën e SMS-ve të të akuzuarit,

Janë regjistruar SMS-të gjatë kontaktit që kan pasur i akuzuari dhe i dëmtuari, më dt: 24.07.2014, vërtetohet fakti se i akuzuari me telefonin e tij nr..... si dhe me nr..... me të dëmtuarin kan komunikuar shumë herë njëri me tjetrin, nga këto SMS-së viktimja i kërkon të hollat nga i dyshuari, ndërsa i dyshuari ju përgjigjet se të hollat ja kishte dhen personit X.

Nga Memorandumi zyrtar i Policisë së Kosovës i dt: 23.02.2015 dhe 11.03.2015

Konstatohet se kundër të akuzuarit F.A. nga një ankesë e E.M., fillimisht është hapur rasti DHEKEK-RF 2015 pran Njesisë Rajonale në Ferizaj, gjatë hetimeve të zhvilluara hetuesit e kësaj njësie, në bazë të dëshmime të grumbulluara dhe procesverbaleve të dëshmitarve: E.M., H.M., ka rezultuar dyshimi i bazuar se për të akuzuarin F.A. qëndrojnë elementet e veprës penale ushtrim i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së.

Vlersim ligjor i veprimeve te akuzuarit

Gjykata ka konstatuar pertje dyshimit te arsyeshëm se ne veprimet e te akuzuarit janë prezentë te gjitha elementet objektive dhe subjektive te veprës penale ushtrim i ndikimit nga neni 431 par.1 te KPRK-së, meqë i akuzuari me qëllim të ndikimit tek personat zyrtar nga bashkëshortja e te dëmtuari E.M. ka kërkuar të hollat në shumë prej 7000 euro, ku e dëmtuara F.M. në pamundësi të dorzimit të këtyre të hollave pasi që e njëjta jetonte në Zvicerr ka

kërkuar nga shoku i E.M., H.M. të i ja dorëzoj të hollat F.A., ku i n jehti përmes telefonatave i ja ka dërguar te hollat F.A. te pompa e derivateve

Vlersimi i mbrojtjes së të akuzuarit dhe vlersimi i tezës së mbrojtësit të tij

Gjykata me kujdes të veçant ka vlersuar tezën e mbrojtjes së të akuzuarit dhe tezën e mbrojtjes së tij, se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale, dhe se e gjithë kjo ka qenë një sajim në mes të dëmtuarit E.M. dhe të mbrojturit të tij F.A., kinse për të ndikuar tek personat zyrtar për të u liruar nga paraburgimi E.M., i cili kishte qenë i ngarkuar për veprën penale kontrabandimi me migrant dhe në pamundësi që të i ja kthejë të hollat personalisht personave të kontrabanduar së bashku me të mbrojturin e tij kanë sajuar punën e intervenimit para bashkëshortes së të dëmtuarit për lirim e tij.

Mirëpo këtë mbrojtje trupi gjykues nuk e aprovoj nga se është e pa qëndrueshme, është në kundërshtim me të gjitha provat e prezantuara në shqyrtimin gjyqësor si me dëshminë e të dëmtuarit njëashtu me dëshmit e dëshmitarve të dhëna në procedurën hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, si dhe me provat materjale, përkatësisht me SMS e paraqitur nga i dëmtuari, sipas memorandumit zyrtar të policisë i dëmtuari E.M. e ka hapur rastin kundër të akuzuarit për veprën penale, ushtrim i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fjalës përfundimtare të mbrojtësit të akuzuarit av. Sh.Sh., trupi gjykues konstaton se në pretendimet e tij përmban kundërshtime. Meqë me njërën anë konsideron se në veprimet e të pandehurit nuk manifestohen elemente të veprës penale Ndikimi i ushtrimit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta liron nga akuza, ndërsa në anën tjetër konsideron se nëse në veprimet e të akuzuarit manifestohen veprime të veprave penale atëherë kemi të bëjmë me veprën penale mashtrimi ku dhe i njëjti ka kërkuar ndryshimin e aktakuzës dhe ricilsimin e veprës penale .

Përcaktimi i dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojn në llojin dhe lartësin e dënimit, si rrethan lehtësuese, gjykata morri parasysh faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër penale, është i martuar, ka qenë korrekt para gjykatës, ndërsa si rrethan rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjigjesisë penale,

rrezikshmërin konkrete të veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale ku i akuzuari me qëllim kinse të ndikimit tek personat zyrtar ka përfituar shumen prej 7000 euro nga i dëmtuari, ku mbi bazën e të gjitha këtyre rrethanave gjykata i vërtetoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1/një/viti**, i cili dënim do të ekzekutohet pasi aktgjykimi të merre formën e prerë.

Kërkesa pasuroro juridike dhe shpenzimet e procedurës penale

Konformm nenitr 463 par. 2 të KPPRK-së, obligohet i akuzuari F.A. që të dëmtuarit E.M.t të i ja kthej dëmin e shkatkuar në vlerë prej 7000 euro.

Vendimi për paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, është i bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-se, e cila shumë është caktuar duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale dhe gjendjen ekonomike të akuzuarit.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA PKR 108/15 Me, 16.04.2014

Sekretarja juridike
Adelina Sallahu

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Sahit Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh pas pranimit te kopjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.